



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
SEKRETARIA

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .02.2021

**MBLEDHJA Nr. 06,  
datë 04.02.2021, ora 10:30  
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 04.02.2021, ora 10:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 06 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi nje ndryshim ne vendimin nr. 34, datë 09.02.2018 “Mbi licencimin e shoqërisë “Alesio – 2014” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kryezi”, me fuqi të instaluar 1990 kW” dhe ne vendimin nr. 180, datë 20.08.2018 “Mbi licencimin e shoqërisë “Alesio – 2014” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Fushë Arrëz” me fuqi të instaluar 1990 kW”
2. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Guri i Zi” me kapacitet të instaluar 1719 kW, Hec “Daznjanë” me kapacitet të instaluar 1518 kW, dhe Hec “Shëlli” me kapacitet te instaluar 1518 kW, me kapacitet total të instaluar 4755 kW
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 63, datë 13.06.2008, i ndryshuar
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 06.08.2008, i ndryshuar

7. Mbi kërkesën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 89, datë 06.08.2008, i ndryshuar

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**